



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:088026

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06188473

KPPP.nr. 518/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit KSF “Rojet e Nderit” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70330428, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Doruntina Rexhaj, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 201/24, i lejuar me datë 11.03.2024 nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 201/24, i lejuar me datë 11.03.2024 nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 208.00 (dyqind e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KSF “Rojet e Nderit” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 20/2022 të datës 18.02.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 201/24 të datës 11.03.2024, me të cilin është urdhëruar debitori Komuna e Prishtinës, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas pranimit të urdhrit kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 19,167.84 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e katër cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive,

si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përbarim.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetim se propozimit për përbarim i është bashkangjitur fatura e cila nuk i plotëson kushtet esenciale si dokument i besueshëm sipas nenit 22 dhe 29 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura nuk është e pranuar dhe nënshkruar nga debitori, nuk është specifikuar detyrimi i debitorit, andaj si e tillë është e pa përshtatshme për përbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri për përbarim të abrogohet.

Kreditore, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigje ndaj prapësimi ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetim se nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, duke mos ofruar prova për të mbështetur pretendimet e tij sipas nenit 69, par. 4 të LPP-së. Ka shtuar se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të faturës e cila është e nënshkruar nga debitori dhe e protokolluar me datë 2.02.2022, andaj e njëjta i plotëson të gjitha tiparet për përbarueshmëri, sipas nenit 29 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 20/2022 e datës 18.02.2022, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje

sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e protokollit të debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet përfaqësueses së kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në shumën prej EUR 208.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve e datës 18.03.2017, lidhur me parashtrësat për përmbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 518/24, datë 20.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.